

Ditari Natyres

**“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A
“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”**
Nr. 14 Viti i dytë i botimit Korrik 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, aty ku flasin mrekullitë e natyrës
- Nënshkruhet Marëveshja e Bashkëpunimit midis AKT-së dhe INCA-s
- Konferenca e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë
- Dita e Peshkimit në liqenin e Kukësit
- Mblidhet Komiteti i Menaxhimit i Parkut Detar Karaburun-Sazan
- Mision Monitorimi në kuadër të Programit SENIOR -A
- Vizitë në Qendrën Ekologjike të Edukimit Mjedisor “EDEN” në Tiranë

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta, aty ku flasin mrekullitë e natyrës

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta (PKDK) është kompleksi ligatinor më i madh jo-bregdetar në Shqipëri, i përbërë nga katër lagunat (Karavasta, Godullat, Godullat e Pishës, Spiaxho) me një sipërfaqe prej afro 5.000ha,

duke përfshirë dunat e rërës dhe deltën e lumit që ndodhet në pjesën qendrore të Rajonit Perëndimor, ndërmjet lumit Shkumbin në veri dhe lumit Seman (Kanali i Myzeqesë) në jug, 40km në perëndim të qytetit të Lushnjës nga ana e bregdetit Adriatik. Laguna e Karavastasë është sipërfaqja më e madhe (4.100ha) e këtij kompleksi ligatinor; ajo është 15.4km e gjatë dhe 4.1 km e gjerë. Thellësia maksimale është 1,3m dhe ka një thellësi mesatare prej 0.7m. Në pjesën lindore kompleksi është i rrethuar nga Kodrat e Divjakës, 18km të gjata dhe 5km të gjera. Pika më e lartë është Guri i Gomares me 192m mbi nivelin e detit, ndërsa sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është rreth 6.500ha. Laguna është e ndarë nga deti prej pyllit me pisha të Divjakës dhe në pjesën lindore tokat bujqësore kufizohen me lagunën. Laguna është e ndarë nga deti me pyllin e pishës së Divjakës dhe lagunën e Godullës.

Karavastaja është një nga tri zonat Ramsar në Shqipëri: ajo është strehë për një numër të madh të shpendëve dimëruar, ajo është gjithashtu një vend i rëndësishëm për shumë specie me interes të madh të ruajtjes, si Pelikani dalmat (*Pelecanus crispus*).

Vijon në faqe 2



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE CAJUPI
Bashkejeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



SWEDEN

Vijon nga faqe 1

Turizmi ka përjetuar disa përmirësime gjatë viteve të fundit në qytetin e Divjakës, rrethinat e saj dhe plazhin e Divjakës. Kohët e fundit, turizmi është zgjeruar, si për nga llojshmëria e lartë e habitateve, si dhe potencialet natyrore dhe kulturore të zonës që ofrojnë një shumëllojshmëri të lartë të mundësive të turizmit: banja dielli (plazh), sportet e ujit, safari, turizëm rural, malor, kulturor, hiking, etj. Megjithatë, Parku Kombëtar aktualisht është duke vuajtur nga mungesa e menaxhimit të integruar dhe mungesa e aktiviteteve të vetë-qëndrueshme të turizmit. Vetëm turizmi i plazhit gjatë verës është duke u promovuar aktualisht dhe ai gastronomik gjatë vitit.



Gjithashtu, gjetetia e paligjshme është një problem i madh në zonën e parkut dhe ndalimi i saj në mars 2014 pritet që gjithashtu të ndikojë pozitivisht në praninë e shpendëve në zonë.

Ekspertët dhe palët e interesuara vërejnë se ky park, që ndodhet në zemër të rajonit perëndimor të Shqipërisë, ofron mundësi të mira për të vizituar atraksione natyrore, por edhe ato arkeologjike, si Kisha Bizantine, shek. i XVIII, në fshatin e Karavastasë së Re (24km) dhe Manastiri i Ardenicës, shek. XVIII – XIV, pranë fshatit Kolonjë (28km). Ky i fundit është shpallur monument kulture me rëndësi të veçantë.

Divjaka është qyteti më i afërt i parkut (afërsisht 6km) me një popullsi prej rreth 13,960, prej të cilëve rreth 8,000 qytetarë banojnë në territorin e bashkisë dhe të tjerët në fshatrat përreth. Banorët vendas punojnë përgjithësisht në bujqësi, dhe veçanërisht në kultivimin e perimeve, drurëve frutorë, peshkim dhe në një shkallë më të vogël, me mbarështimin e blegtorisë.


Hyrja për në park kryhet nëpërmjet rrugës kryesore që lidh Divjakën me Parkun Kombëtar. Rruga e ndan pyllin në dy pjesë (Veriun dhe Jugun). Hyrja për në park ndodhet 1.2km në very të qendrës së parkut dhe plazhit, ndërkohë që aplikohet një taksë për hyrjen e vizitorëve dhe makinave në park.

Qendra e parkut ndodhet pranë plazhit të Divjakës, afërsisht 1.2km në jugperëndim të hyrjes së parkut. Shumica e shërbimeve ndodhen në qendër të parkut. Plazhi i Divjakës është një rrip prej përafërsisht 15 kilometrash rëre të bardhë që kufizohet me një pyll pishash dhe përbën një destinacion të kërkuar plazhi për

mijëra turistë dhe vizitorë një-ditorë, kryesisht nga Shqipëria jug-qendrore. Plazhi i rërës është i madh (250m nga linja e ndarjes së pyllit me pisha në vijën bregdetare), dhe madje, edhe gjatë kulmit të sezonit, është e mundur që duke lëvizur përgjatë kësaj ndarjeje të sigurohet një farë privatësie.

Ishulli i Pelikanit (Monument Natyror) ndodhet në veri-perëndim të Lagunës së Karavastasë. Ky është një vend i rëndësishëm për mbarështimin e Pelikanëve Dalmatë. Pisha e Egër në Oazin e Karavastasë është gjithashtu e renditur si një Monument Natyror në Shqipëri. Ajo përfaqëson një pemë pishe 410-vjeçare që ndodhet në jug-perëndim të pjesës veriore të pyllit.

Laguna e Karavastasë është laguna më e madhe dhe më e rëndësishme e zonës bregdetare të Detit Adriatik. Ajo ka një sipërfaqe prej 43.3km², me një gjatësi maksimale prej 10.6km, gjerësi maksimale prej 4.3km, dhe thellësi maksimale prej 1.5m. Laguna e Karavastasë është e mirënjohur për koloninë e specieve të rrezikuara botërore të Pelikanit Dalmat. Prania e këtyre shpendëve është edhe një nga arsyet kryesore që laguna e Karavastasë është përcaktuar si Zonë Ramsar e Rëndësisë Ndërkombëtare. Gjithashtu, më tepër se 200 lloje të tjera shpendësh mund të vëzhgohen në këtë zonë, duke përfshirë edhe disa specie të tjera botërore të rrezikuara, siç janë karabullaku i vogël, rosa kokëbardhë, shqiponja me njolla dhe fajkoi i hirtë.



Laguna e Godullës përfaqëson një lagunë të vogël që ndodhet shumë pranë lagunës së Karavastasë. Ajo ka një sipërfaqe prej 8.5km² me gjatësi prej 5km, gjerësi

3.8km dhe thellësi maksimale prej 3.8m.

Godulla e Pishës (Monument Natyror) ndodhet në veri-perëndim të pyllit të Divjakës. Ajo përfaqëson një lagunë me gjatësi maksimale prej 1.8km dhe gjerësi maksimale prej 400m, e cila rrethohet nga pylli i pishës dhe dunat me hala pishe. Pelikanët Dalmatë folezojnë në këtë zonë.

Spiaxho është një lagunë e vogël në pjesën veriore të sistemit kënetor të kompleksit Divjakë-Karavasta. Këneta e Osmanit është një lagunë e vogël në veri të lagunës së Spiaxhos.

Ishulli i Kularit (Monument Natyror) ndodhet pranë deltës së lumit Shkumbin, 0,5m mbi nivelin e detit, i formuar si rezultat i prurjeve aluvionale të

Vijon nga faqe 2

lumit. Ishulli është i mbuluar nga shkurret, plepi i egër, druri i kedrit, kullotat dimërore dhe lloje të ndryshme vegjetacioni të gjelbër. Aty mund të gjenden disa lloje shpendësh ujorë, dhe veçanërisht, pelikani Dalmat.

Dokumentet e zhvillimit strategjik të hartuar nga Ministria e Turizmit e identifikojnë lagunën e Karavastasë si një zonë me “vlera tepër të rëndësishme të biodiversitetit”.

Parku Kombëtar i Pishës së Divjakës është i mirënjohur për vlerat me të vërtetë unike ekologjike dhe manifestimet e tjera natyrore. Bimësia dhe llojet e kafshëve janë të larmishme dhe veçanërisht të bukura. Parku shërben gjithashtu, edhe si strehë për mjaft shpendë të rrallë, përfshirë edhe specien e rrezikuar të pelikanit. Kjo është edhe pika më perëndimore e folezimit të këtij lloji shpendi në të gjithë Evropën. Zona e parkut rekomandohet gjithashtu edhe për vlerat tërheqëse të ekosistemit të tij, me 210 lloje shpendësh, 12 lloje

gjitarësh dhe 16 lloje zvarranikësh. Parku mbizotërohet prej zonave të pishave të buta dhe të egra, ku dallohen veçanërisht pishat me kurorë të madhe. Pylli shumëkatësh është mjaft i pasur me barëra dhe pemë të larta. Flora e Parkut Kombëtar të Divjakës shquhet posaçërisht për bukurinë dhe freskinë e veçantë të saj.

Gjithashtu, ujërat e lagunës, të cilat arrijnë afërsisht 1.5 metra thellësi, janë të pasura me peshq, veçanërisht qefull dhe ngjala, gatimi i të cilave ofrohet në shumë prej restoranteve të plazhit të Divjakës.

Plazhi ranor i Divjakës është i pasur me sasi të konsiderueshme jodi dhe temperaturë mbi 200C, që fillon qysh prej gjysmës së dytë të muajit maj dhe vazhdon deri në fillim të tetorit. Kjo është një zonë ku aktivitetet e plazhit mund të ndërthuren lehtësisht me eko-turizmin. Rreth 300.000 pushues vizitojnë plazhin e Karavastasë çdo vit, me rreth 8.000 vizitorë në ditë në verë. Shumica e vizitorëve vijnë me makina.

Nënshkruhet Marëveshja e Bashkëpunimit midis AKT-së dhe INCA-s

Tiranë, 5 Qershor 2014 - Dita Botërore e Mjedisit, 5 qershori u caktua si e tillë në vitin 1972, nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-s me qëllim shtimin e vetëdijes rreth çështjeve të mjedisit dhe për të tërhequr vëmendjen politike ndaj këtyre çështjeve si dhe për të nxitur veprimin individual në këtë drejtim. U zgjodh kjo datë sepse përkon me ditën e hapjes së Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin, që u mbajt në vitin 1972 në Stokholm.

Qëllimi i kësaj ngjarje është të nxisë aktivitete dhe aksione

për të arritur ndryshime pozitive në mbrojtjen e mjedisit. Kjo dite zakonisht përcillet me një tematikë të caktuar.

Në të kaluarën tema të kësaj ngjarjeje kanë qenë kujdesi për tokën dhe ujin, mbrojtja e shtresës së ozonit, ndryshimet klimatike dhe zhvillimi i qëndrueshëm, duke patur gjithnjë në fokus ruajtjen e shëndetit njerëzor. Tema e këtij viti është “Ngri zërin tënd, jo nivelin e detit”.

Në këtë kuadër, në mbarë botën organizohen aktivitete ndërgjegjësuere në ruajtje të mjedisit.

Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT) dhe Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit dhe në kuadër të promovimit të

natyrës shqiptare dhe vlerave të saj, nënshkruan një marëveshje bashkëpunimi, e cila ka në themel të saj bashkëpunimin në kuadër të zhvillimit, promovimit dhe ruajtjes së vlerave natyrore të Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, të promovojë aktivitetet dhe projektet për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe kryesisht ato me bazë natyrore, të mbështesë dhe promovojë zonat e mbrojtura dhe aktivitetet turistike që zhvillohen në to, etj. Për Agjencinë Kombëtare të Turizmit marrëveshja u firmos nga Drejtoresha e Përgjithshme e këtij institucioni, Znj. Julinda Dhame, kurse për INCA-n nga Presidenti i Bordit të Menaxhimit të INCA-s Z. Zamir Dedej. Gjatë firmosjes i pranishëm ishte edhe Z.

Mihallaq Qirjo, Drejtor i REC Shqipëri i cili theksoi se REC Shqipëri mbështet këtë nismë të ndërmarrë nga dy institucionet e cila do të zhvillojë akoma më shumë turizmin

shqiptar dhe promovimin e zonave të mbrojtura me theks për të joshur jo vetëm turistin e huaj por edhe atë vendas. Me këtë rast u shfaqën edhe dy spote me interes, ai i turizmit dhe spoti i zonave të mbrojtura. Gjithashtu drejtuesit e dy institucioneve prezantuan edhe politikat që do të ndiqen në zhvillimin e turizmit si dhe aktivitetet që do të zhvillohen në zonat e mbrojtura shqiptare.



Konferenca e Parë e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë

Tiranë, 11-12 Qershor 2014 - U organizua për herë të parë Konferenca Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të Shqipërisë, një iniciativë e organizatës WWF (Fondi Botëror për Natyrën) në bashkëpunim me INCA (Instituti i Ruajtjes së Natyrës në Shqipëri) dhe Ministrinë e Mjedisit. Konferenca u organizua si një nga aktivitetet më të spikatura të



projektit Parqet Dinarike të Shqipërisë me pjesëmarrjen e 50 specialistëve, menaxherëve dhe ekspertëve të zonave të mbrojtura. Ata diskutuan mbi situatën reale të Zonave të Mbrojtura në Shqipëri dhe sfidat e menaxhimit të qëndrueshëm të këtyre pasurive natyrore në të ardhmen. Zonat e Mbrojtura përbëjnë 16 përqind të territorit të Shqipërisë dhe janë pjesë e çmuar e trashëgimisë natyrore për vlerat unike të biodiversitetit.

Si pasuri kombëtare që mbartin përfitime të shumë anshme ekonomike dhe mjedisore, ato gëzojnë mbrojtje të veçantë me qëllim që t'ju shërbejnë qytetarëve shqiptarë me shërbime mjedisore si dhe si destinacione të çlodhjes në natyrë. Konferenca mbështeti krijimin e një

organizate të stafit shqiptar të Zonave të Mbrojtura që shkëmben eksperiencat menaxhuese me kolegët e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe do të jetë aktori shqiptar në zhvillimin e mëtejshëm të projektit Parqet Dinarike të Shqipërisë.

Mes të tjerash në fjalën e tij Z.Paolo Lombardi, Drejtor i WWF për Programin e Mesdheut theksoi se “Zonat e



mbrojtura do të kenë një rol në rritje si një strategji për të mbrojtur pasuritë natyrore të vendeve dhe rajoneve. Zonat e mbrojtura janë të nevojshme për të siguruar një rrjedhë përfitimesh të tilla si uji, mbrojtja e tokës, reduktimi i karbonit, elasticiteti ndaj ndryshimeve klimatike, mbështetja për industrinë e turizmit, hapësirat clodhëse për komunitetet. Projekti DAP dhe ne nga WWF jemi këtu për të

ndihmuar vendet e rajonit të Adrias për të zhvilluar me largpamësi mundësitë e ofruara nga zonat e mbrojtura”.

Në kuadër të kësaj Konference, WWF dhe INCA, partneri shqiptar në këtë projekt, organizuan edhe një vizitë me median dhe pjesëmarrësit në Parkun Kombëtar të Divjakës.

Dita e Peshkimit në Liqenin e Kukësit

Kukës, 13 Qershor 2014- Në kuadër të programit SENiOR-A,

mbështetur nga REC Albania dhe Qeveria Suedeze, OJF Mbrojtja e Mjedisit në Kukës organizoi në qytetin e Kukësit Ditën e Peshkimit.

Në këtë veprimtari morën pjesë organizata të shoqërisë civile, pjesë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, Këshilli i Qarkut Kukës, SWG (Njësia e Menaxhimit të Projektit Regjioni Ndërkufitar "Sharra"), OMP Kukës, përfaqësues të shoqatës së "Peshkatarisë Sportive dhe Rekreative" të Kosovës, përfaqësuese të Ministrisë së Bujqësisë si dhe institucioneve vendore. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte



sensibilizimi i opinionit për parandalimin e gjuetisë së peshkut me mjete të paligjeshme, promovimin e vlerave natyrore, biologjike, turistike e ekonomike të pellgut ujëmbledhës të Liqenit të Fierzës, vlerat kulinare të llojeve peshkore që gjallojnë në këtë pellg ujor, si dhe promovimin e produkteve të rrushit të kësaj zone si

verëra, raki etj nga prodhues vendore.

13 Qershori me vendim të Këshillit të Qarkut Kukës do të jetë dita lokale e përvitshme e peshkimit.

Në fund të takimit u organizua edhe një udhëtim me traget në liqenin e Kukësit.



Mblidhet Komiteti i Menaxhimit i Parkut Detar Karaburun-Sazan

Orikum 13 Qershor 2014 - Në ambientet e Bashkisë Orikum u mbajt Komiteti i 4 Drejtues i Parkut Detar Karaburun-Sazan, i cili aktualisht është duke luajtur edhe rolin e Komitetit të Koordinimit të Projektit.

Në takim morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme në nivel lokal dhe qendror si Kryetari i Bashkisë



Orikum, Drejtoresha e Përgjithëshme UNDP, Përgjegjësi i Zonave të Mbrojtura në Ministrinë e Mjedisit, Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Mjedisit në Vlorë, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, Përgjegjës i Sektorit Detar në zyrën e WWF MedPO, përfaqësues të Conservatoire du Littoral, OJQ lokale.

Nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) ishin të pranishëm Presidenti i Bordit, Z. Zamir Dedej, dhe Koordinatorja e Projektit SEA-Med, Znj. Marinela Mitro. Normalisht Komiteti mblidhet rregullisht çdo gjashtë muaj për të diskutuar dhe konsultuar në mënyrë shumë aktive çështjet e menaxhimit të ZMD. Çështja më

e rëndësishme për diskutim në këtë takim ishte procesi i hartimit të planit të menaxhimit të ZMD për të cilin projekti UNDP ka kontraktuar WWF dhe hartimi i Planit të Menaxhimit Turistik i cili gjithashtu është në proces në kuadër të projektit “Aktivitete të qëndrueshme ekonomike në ZMD Mesdhatare”.

Z.Giuseppe Di Carlo (Përgjegjës i Sektorit Detar në zyrën e WWF MedPO), ishte i pranishëm në këtë takim dhe prezantoi punën e bërë deri tani në të dy planet e menaxhimit në proces, në bashkëpunim me ekspertët kombëtarë dhe



ndërkombëtarë si dhe hapat e ardhshëm dhe veprimet që duhet të ndërmerren për gjashtë muajt e ardhshëm. Të pranishmëve ju

prezantuan përfundimet e studimeve të zhvilluara për aktivitetet turistike të bazuara në natyrë, vlerësimi i sistemit të certifikimit në Shqipëri, zhvillimi i strategjisë së komunikimit, workshop të ndryshëm dhe aktivitetet trajnuese të zhvilluara, etj.

Mision Monitorimi në kuadër të Programit SENiOR-A

Ulëz-Kukës, 24-25 Qershor 2014 - Në kuadër të Programit SENiOR-A (Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile) me financim të Qeverisë Suedeze dhe asistencë të REC Shqipëri, monitoruesi i këtij programi Z. Gunnar Olesen, zhvilloi një vizitë dy ditore në qytetën e Ulzës dhe në qytetin e Kukësit ku zhvillojnë veprimtarinë dy organizata anëtare të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, Miqësia Ulëz dhe Mbrojtja e Mjedisit Kukës.

Gjatë vizitës në ambientet e punës të dy organizatave Z. Olesen u njoh me historikun, misionin dhe objektivat e punës së tyre, aktivitetet, bashkëpunimin me organizatat e tjera që veprojnë në fushën e mbrojtjes së natyrës, anëtarësinë e organizatave si dhe vullnetarët që veprojnë në to.

Z.Olesen vlerësoi maksimalisht punën e bërë nga këto dy organizata anëtare të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës dhe i inkurajoi ato në vazhdimin e misionit, shtimin e kontributit dhe rritjen e rrolit të tyre në nivel lokal dhe kombëtar.



Vizitë në Qendrën Ekologjike të Edukimit Mjedisor “EDEN” në Tiranë

Tiranë, 5 Qershor 2014 - Data 5 qershor 2014 shënon Ditën Botërore të Mjedisit që prej vitit 1973. Këtë ditë

Qendra EDEN e festoi duke ri-hapur Qendrën Ekologjike të Edukimit Mjedisor “EDEN” pranë Kopshtit Zoologjik në Tiranë. Qendra



është ndërtuar për herë të parë në vitin 2007-2008 me mbështetjen financiare të Ambasadës Amerikane në Tiranë dhe Bankës ProCredit. Për shkak të ndërtimit të Unazës së Madhe të Tiranës në vitin 2011, kjo qendër u ç'montua. Rikthimi sërish në jetë i saj erdhi si pasojë e mbështetjes financiare të GEF/SPF (Global Environment Facility) Shqipëri.

Në këtë shtëpi ekologjike ndricimi dhe ngrohja e ujit realizohen me panele diellore, furnizimi me ujë realizohet nga sistemi i grumbullimit të ujit tëshiut dhe për fundon në një depozitë, është ndërtuar gropa septike e cila është lidhur me sistemin e kanalizimeve dhe shumë ide të tjera ekologjike janë në përpunim për të ardhmen ndërkohë që funksioni i saj kryesor është Edukimi Mjedisor.

“Përveçse një model i gjallë se si mund të funksionojë një shtëpi ekologjike, kjo qendër përfaqëson insistimin e organiztës dhe të mbështetësve të saj që nisma të tilla të mos zhduken nga faktorë të ndryshëm por të qëndrojnë fort në këmbë. Gjërat e mira duan punë dhe këmbëngulje për të qenë të qëndrueshme!” – shprehet Z. Gace Koordinator lokal i GEF i pranishëm në aktivitet.

Shtëpiza do të qëndrojë vazhdimisht e hapur, dhe aktualisht skuadra e qendrës EDEN po punon në rimodelimin e prorgamit mjedisor që zhvillohet aty. Kështuqë qëndroni vazhdimisht të përditësuar me ne



<https://www.facebook.com/media/set/?set=a.10152242526102561.1073741864.319334287560&type=3>

Aktiviteti u zhvillua në kuadër të projektit “Promovimi i energjisë alternative me shembuj konkret në sytë e qytetarëve!” në partneritet me shoqatën “Together for life” i mbështetur financiarisht nga GEF Shqipëri.

Qendra EDEN

NJOFTIME

- 1 - Opportunities of Study in Japan
http://www.it.emb-japan.go.jp/italiano/albania/scholarship_2015.html
- 2- Japanese Government Scholarship for 2015 (Research student)
http://www.mext.go.jp/a_menu/koutou/ryugaku/boshu/1346643.htm

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org